

**Marrëveshje Transferimi
të Pjesëve të Kapitalit të shoqërisë
“DARKTRACE ALBANIA” Sh.p.k**

Në Tiranë, sot më 25/09 2019 , palët e kësaj Marrëveshjeje ranë dakort si më poshtë:

Shitesi:

Shoqëria **DARKTRACE LIMITED**, e regjistruar ne regjistrin e shoqerive per Angline dhe Uellsin, me nr 8562035, eshte ortake 100% e kapitalit te shoqerise Darktrace Albania te regjistruer ne Qendren Kombetare te Biznesit me NIPT L92124030H, perfaqesuar nga administratoret e saj :

- Eaton Richard
- Eagan Nicole
- Elizabeth Jane Harris

(më poshtë referuar “SHITËSI”)

Blerësi:

Z. Marco Mancini, shtetas italian, i datëlindjes 12/03/1980,banues ne Rome, mbajtes i kartes se Identitetit me nr. AX8769534, , madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar.

(më poshtë referuar “BLERËSI”)

MEQËNËSE:

- A. **Shitësi** zotëron 100% të Kapitalit të Shoqërisë “**Darktrace Albania**” **Sh.p.k**, një shoqëri ekzistuese sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, e regjistruar në Regjistrin Tregtar Shqiptar me NIPT L92124030H, me seli ne adresen: Rrugen Frank Bardhi, Pallati 2, Kati 2, (Qendra Kristal) Tirana. (“Shoqëria”) me një kapital prej 1.000.000,00 lekë,.
- B. **Blerësi** dëshiron të blejë 100% të Kapitalit të Shoqërisë të zotëruar nga Shitësi në shoqërinë e lartpërmendur “**Darktrace Albania**” **Sh.p.k**, sikurse përcaktohet në këtë marrëveshje.
- C. Në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar dhe nenet e Statutit të Shoqërisë, Asambleja e Ortakëve të shoqërisë ka vendosur sipas vendimit bashkëngjitur kësaj marrëveshje.

PËR SA MË SIPËR, palët bien dakort si më poshtë:

1. Shitësi pranon se ka marrë nga Blerësi në mënyrë të plotë të gjithë çmimin e blerjes të rënë dakord në vlerën nominale të kuotave, konkretisht çmimin prej 1.000.000 lekë dhe për këtë arsye transferon këtu 100% të kapitalit të zotëruar nga Shitësi në kapitalin e Shoqërisë “**Darktrace Albania**” **Sh.p.k**, në pronësi të Blerësit.
Shitësi deklaron dhe garanton Blerësin se 100% e kapitalit që transferohet këtu është në pronësinë e tij të plotë ligjore dhe të lira nga barra, hipotekë apo pengje.

2. Blerësi pranon pronësinë e 100% të kuotave të kapitalit të shoqërisë, duke njohur gjëndjen e Shoqërisë dhe bie dakord me të gjitha të drejtat dhe detyrimet e lindura nga zotërimi i këtyre Kuotave brenda Shoqërisë, sipas përcaktimeve të Statutit të Shoqërisë dhe ligjit shqiptar.
3. Me nënshkrimin e kësaj Marrëveshje, ortak i vetëm shoqërisë dhe pjesët e kapitalit të zotëruara prej tij në shoqërinë **"Darktrace Albania" Sh.p.k** do të jetë:
 - **Z. Marco Mancini**, i cili zotëron 100% të kapitalit të shoqërisë.
4. Shitësi dhe Blerësi bien dakord të zbatojnë dhe të paraqesin që në kërkesën e parë të palës tjetër dhe/ose të Shoqërisë të gjitha dokumentet e nevojshme në mënyrë që të kryejnë të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e transferimit të këtyre Kuotave objekt të kësaj Marrëveshjeje, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit si dhe në çdo autoritet tjetër sipas përcaktimeve të Ligjit Shqiptar.

Kjo Marrëveshje u hartua në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën shqipe me vlerë të barabartë ligjore.

Marrëveshja bazohet në nenin 705 të Kodit Civil (Shqiptar) dhe në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqërite Tregtare", i ndryshuar.

Marrëveshja u lexua nga palët, u gjënd e rregullt, në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë dhe u nënshkrua rregullisht prej tyre.

SHITËSI

DARKTRACE LIMITED

Eaton Richard *Eaton Richard*

Eagan Nicole *Eagan Nicole*

Elizabeth Jane Harris *Elizabeth J Harris*

BLERESI

MARCO MANCINI

Marco Mancini